

Pjesa 1: Ftesë për tender

Furnizim me paletarë dhe peshore

PROC21-RMG-2024

I/e nderuar,

Democracy Plus (D+) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, e themeluar nga një grup aktivistësh të cilët besojnë fuqishëm në vlerat demokratike dhe në një Kosovë demokratike. Qëllimi kryesor i organizatës sonë është të mbështesë vlerat dhe praktikat demokratike në fushën e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, zgjedhjeve dhe partive politike, çështjeve sociale dhe të drejtave të njeriut.

D+ po zbaton Aktivitetin e USAID-it Riciklimi ka rëndësi–Graçanicë që synon të rrisë kohezionin socio-ekonomik në mes të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që angazhohen në grumbullimin joformal të mbeturinave, të sektorit privat, të të rinjve dhe të komunës së Graçanicës, duke krijuar modele të qëndrueshme të riciklimit në bashkëpunim me të gjitha grupet e synuara.

D+ synon që për nevoja të përfituesve të projektit të prokurojë mallrat, si në vijim:

- **Paletarë (2 copë)**
- **Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 500kg (2 copë)**
- **Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 300kg (1 copë)**

Kjo është një ftesë për ofertim për tenderin e lartcekur. Bashkangjitur gjeni dokumentet e mëposhtme, të cilat përbëjnë dosjen e tenderit:

Pjesa 1: Kjo Ftesë për tender dhe Udhëzimet për ofertuesit

Pjesa 2: Fleta e të dhënave të tenderit (FTD)

Pjesa 3: Letra përcjellëse dhe Deklarata nën Betim

Pjesa 4: Forma e dorëzimit të tenderit

Procesi i prokurimit i filluar më **28 qershor 2024** do të zhvillohet përmes procedurës së hapur siç është përcaktuar në Procedurat e Prokurimit të Democracy Plus.

Pyetjet mund të dërgohen me shkrim në mënyrë elektronike tek procurement@dplus.org më së largu deri me 05 korrik.

Ofertat mund të dorëzohen në formë elektronike tek email adresa e shënuar më poshtë. Afati i fundit për dorëzim të ofertave është: **08 korrik 2024, ora 17.00.**

Ju faleminderit,

Democracy Plus

Udhëzime për ofertuesit

Ky prokurim kryhet në përputhje me Politikën e Prokurimit të D+ si autoritet kontraktues, dhe në përputhje me rregullat, praktikat dhe udhëzimet e donatorit për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Të gjitha aktivitetet e prokurimit nga Democracy Plus kanë synim që të karakterizohen nga përdorimi efikas i burimeve, promovimi i praktikave të mira administrative, transparencja në menaxhimin e fondeve dhe parandalimi i korrupsionit. Parimi bazë është që të gjitha prokurimet e bëra nga Democracy Plus do të karakterizohen nga praktika të mira biznesi, konkurrenca e ndershme, çmimi i tregut, integriteti dhe paanshmëria.

Ofertuesit duhet t'u përmbahen të gjitha kërkesave të kësaj oferte, duke përfshirë çdo ndryshim ose shtojcë me shkrim nga Democracy Plus.

Gjatë përgatitjes së ofertës, ofertuesit pritët të shqyrtojnë në detaje Ftesën për tender. Mangësitë materiale në dhënien e informacionit të kërkuar në Dosje mund të rezultojnë në refuzimin e ofertës.

Ofertuesit duhet të kujdesen që të dorëzojnë të gjitha dokumentet e renditura në Ftesën për tender. Asnjë pretendim nuk do të merret në konsideratë nga Autoriteti Kontraktues që vie nga dështimi për të analizuar detajet e përfshira këtu ose për të marrë një informacion të tillë.

Ofertat e pranuar pas datës së së përcaktuar në ftesën për tender nuk merren parasysh.

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të refuzuar një ose të gjitha ofertat e pranuar ose të kërkojë shpjegime të mëtejshme nga tenderuesit.

Para dhënies së kontratës, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit të japin informacion shtesë ose të kërkojë takim për të ndihmuar procesin e vlerësimit.

Pjesa 2: Fleta e të dhënave të tenderit (FTD)

1	Qëllimi i kontratës	Furnizim me: Paletarë (2 copë) Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 500kg (2 copë) Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 300kg (1 copë)
2	Ndarja në lote	Jo
3	Përshkrim i shkurtër i furnizimeve të kërkuara	<ul style="list-style-type: none">- Paletarë (2 copë)- Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 500kg (2 copë)- Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 300kg (1 copë)
4	Specifikat teknike të detyrueshme	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikat teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në dosjen e tenderit.

5	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)	Oferta nuk duhet të përfshijë TVSH-në
6	Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	Dërgesa duhet të bëhet në Graçanicë. Ofertuesit duhet të kenë kapacitete teknike për të dorëzuar furnizimin.
7	Data e synuar për fillim të kontratës	30 korrik 2024
8	Afatet kohore për dorëzimin e furnizimeve ose përfundimin e kontratës	30 ditë
9	Pagesa	Pagesa do të bëhen brenda periudhës 30 ditore nga data e furnizimit të tërësishëm të mallrave.
10	Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	Certifikata Regjistrimit të Biznesit; Certifikata e TVSH-së (nëse ka) Certifikata me Numër Fiskal Dëshmi nga ATK që kompania nuk ka borxhe të papaguara Marrëveshje bashkëpunimi (autorizimi) dhe katalogu nga prodhuesi për pajisjet e ofruara
11	Validiteti i ofertave	Periudha minimale e vlefshmërisë së ofertave duhet të jetë së paku 45 ditë nga data e ofertimit
12	Nënkontraktimi	Nënkontraktimi nuk lejohet
13	Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik (konsorciumeve)	Lejohet me: <ul style="list-style-type: none"> a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarë, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kësaj dosjeje të tenderit.
14	Pyetjet dhe sqarimet	Pyetjet mund të dërgohen në mënyrë elektronike tek procurement@dplus.org më së voni deri më 05 korrik 2024.
15	Lloji kontratës	Kontratë me çmim fiks
16	Valuta dhe Përshkrimi i Çmimit	Çmimi i ofruar nga Tenderuesi nuk do jetë i ndryshueshëm. Valuta është Euro (€)
17	Kriteret e përzgjedhjes	Çmimi më i ulët, teknikisht i pranueshëm, për ofertues të përgjegjshëm.
18	Gjuha dhe ligji i aplikueshëm	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. Operatorët Ekonomik mund të përgatisin dhe të dorëzojnë tenderët e tyre dhe dokumentet e lidhura në gjuhën shqipe ose serbe. Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhën shqipe, dhe në rast konflikti mes dy versioneve gjuhësore, gjuha e hartimit është gjuha përcaktuese.
19	Ankesat	Ankesat janë të pranueshme dhe shqyrtohen sipas rregullave dhe procedurave të D+. Ofertuesit që konsiderojnë se po trajtohen në mënyrë

		të padrejtë mund të bëjnë ankesë brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit. Ankesat duhet të drejtohen përmes postës elektronike në: ethics@dplus.org . Një vendim adekuat do të merret jo më vonë se 15 ditë nga dita e parashtrimit të ankesës.
20	Dokumentet që duhet të dorëzohen	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesa 3: Letra përcjellëse dhe Deklarata nën Betim; 2. Pjesa 4: Forma e dorëzimit të tenderit; 3. Certifikata e regjistrimit dhe numri fiskal; 4. Shtojca tjera në rast të organizmit si konsorcium (sipas kërkesave të FTD); 5. Dëshmi nga ATK që nuk ka borxhe të papaguara; 6. Dëshmi të cilësisë (sipas kërkesave të FTD); 7. Dëshmi mbi prejardhjen (sipas kërkesave të FTD); 8. Dëshmi që oferta është në pajtueshmëri me specifikat teknike të kërkuara 9. Deklaratë garancioni.

Specifikimet teknike të detyrueshme

- Paletar

Kapaciteti ngarkues: minimum 1200kg;

Lartësia ngritëse: minimum 2m, mirpo nuk duhet të kaloj 2.5m kur është i pangarkuar;

Bateria: Litium ose relevant me kapacitetet përafërsisht 24v/ 85Ah;

Shpejtësia ngritëse me ngarkesë/ pangarkesë: përafërsisht 0.12/0.24M/S;

Pajisur me frena lëshues, frena për të mos lëvizur mbrapa dhe tri lloje të funksioneve frenuese për të garantuar siguri;

Pajisur me veçori sigurie për të parandaluar aksidentet sikur se butonat për ndalimin emergjent, mburojat e sigurisë dhe dritat paralajmëruese;

Sasia: 2 copa

Foto ilustrative



Mirëmbajtja: Ofertuesi duhet të ofrojë garancion që do të vazhdojë të ofrojë pjesë këmbimi dhe mbështetje teknike për së paku 2 vite pas shitjes.

Garancioni: Paisja duhet të vijë me garancion që vlen së paku një vit.

Dëshmi e konformitetit me specifikat teknike: Ofertuesit duhet të ofrojnë dëshmi që oferta është në pajtueshmëri me specifikat teknike të kërkuara.

Plani për trajnim: Ofertuesit duhet të ofrojnë manual përdorimi dhe trajnim për përdoruesit e pajisjeve pas shitjes.

Prejardhja: Furnizuesi duhet të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes së mallrave së bashku me ofertë.

- **Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 500kg (2 copë)**

Kapaciteti peshues: minimum deri në 500 kg.

Saktësia: të jetë e saktë dhe e mirëkalibruar për të siguruar që pesha e regjistruar është e saktë.

Ekrani i shfaqjes: të ketë një ekran të shfaqjes të qartë dhe të lehtë për tu lexuar me informacion për peshën e saktë.

Ndërtimi i trupit: të jetë e ndërtuar me materiale të cilësisë së lartë si çelik i fortë dhe të ketë një trup të qëndrueshëm.

Dimensionet përafërsisht të jenë: 125 x 125 cm. Të ketë këmbë mbështetëse me mundësi nivelizimit sipas pozicionit në dysheme.

Platforma e peshimit: të jetë me sipërfaqe anti-rrëshqitje dhe anti-korroduese (p.sh. llamarinë e profilizuar) dhe e përforcuar me çelik të fortë.

Temperatura dhe lagështia: të jetë e pajisur me sistem mbrojtjeje për të përballuar kushtet e ndryshme të mjedisit si lagështia dhe temperaturat e larta, në përputhje me standardin IP67.

Fuqia e furnizimit: të punojë me energji elektrike, por të funksionojë e pavarur nga rrjeti elektrik, me bateri për një periudhë së paku 4 orë. Tensioni i fuqisë 220V.

Sasia: 2 copë

Foto ilustrative



- **Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 300kg (1 copë)**

Kapaciteti peshues: minimum deri në 300 kg.

Saktësia: të jetë e saktë dhe e mirëkalibruar për të siguruar që pesha e regjistruar është e saktë.

Ekрани i shfaqjes: të ketë një ekran të shfaqjes të qartë dhe të lehtë për tu lexuar me informacion për peshën e saktë.

Ndërtimi i trupit: të jetë e ndërtuar me materiale të cilësisë së lartë si çelik i fortë dhe të ketë një trup të qëndrueshëm.

Dimensionet përafërsisht të jenë: 125 x 125 cm. Të ketë këmbë mbështetëse me mundësi nivelizimit sipas pozicionit në dyshe.

Platforma e peshimit: të jetë me sipërfaqe anti-rrëshqitje dhe anti-korroduese (p.sh. llamarinë e profilizuar) dhe e përforcuar me çelik të fortë.

Temperatura dhe lagështia: të jetë e pajisur me një sistem mbrojtjeje për të përballuar kushtet e ndryshme të mjedisit, si lagështia dhe temperaturat e larta, në përputhje me standardin IP67.

Fuqia e furnizimit: të punojë me energji elektrike, por të funksionojë e pavarur nga rrjeti elektrik, me bateri për një periudhë së paku 4 orë. Tensioni i fuqisë 220V.

Sasia: 1 copë

Foto ilustrative



Mirëmbajtja: Ofertuesi duhet të ofrojë garancion që do të vazhdojë të ofrojë pjesë këmbimi dhe mbështetje teknike për së paku 2 vite pas shitjes.

Garancioni dhe shërbimi: Paisja duhet të vijë me garancion që vlen së paku një vit. Ofertuesi duhet të ofrojë shërbime pas instalimit, si kalibrimin dhe mbështetjen teknike të pas-shitjes.

Dëshmi e konformitetit me specifikat teknike: Ofertuesit duhet të ofrojnë dëshmi që oferta është në pajtueshmëri me specifikat teknike të kërkuara.

Plani për trajnim: Ofertuesit duhet të ofrojnë manual përdorimi dhe trajnim për përdoruesit e pajisjeve pas shitjes.

Prejardhja: Furnizuesi duhet të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes së mallrave së bashku me ofertë.

Mallrat duhet të jenë prodhime vendore ose nga vende nga ku lejohet importimi sipas rregullave dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë. Rregullat e donatorit mbi prejardhjen gjithashtu do të aplikohen. Këto rregulla përfshijnë kërkesat si në vijim: (1) mallrat të mos kenë burim vendet nga “Lista e vendeve burimore të ndaluara” (List of Prohibited Source Countries: <https://www.usaid.gov/about-us/agency-policy/series-300/references-chapter/310mac>) dhe (2) prejardhja e mallrave të jetë nga vende që nuk janë në listën e Zyrës për kontrollin e aseteve të huaja (Office of Foreign Assets Control: <https://ofac.treasury.gov/>)

Pjesa 3: Letra përcjellëse dhe Deklarata nën Betim

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: _____ [operatorin ekonomik] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me këtë dosje të tenderit.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.

Për më tepër, vërtetoj se, sipas njohurive dhe besimit tim:

- Nuk kemi marrëdhënie të ngushta, familjare ose financiare me asnjë ofertues tjetër që dorëzon oferta në përgjigje të Ftesës së lartpërmendur.
- Çmimet në ofertën tonë janë arritur në mënyrë të pavarur, pa asnjë konsultim, komunikim apo marrëveshje me ndonjë ofrues apo konkurrent tjetër me qëllim të kufizimit të konkurrencës.
- I gjithë informacioni në propozimin tonë dhe i gjithë dokumentacioni mbështetës është autentik dhe i saktë.
- Ne kuptojmë dhe pajtohemi me politikat e D+ kundër mashtrimit, rryshfetit dhe konfliktit të interesit.
- Ne nuk kemi deklaruar falimentim, nuk jemi të përfshirë në procedurat e falimentimit ose të marrjes së detyrimeve financiare dhe nuk ka asnjë gjykim apo veprim ligjor në pritje ndaj nesh që mund të dëmtojë operacionet në të ardhmen e parashikuar.
- Nuk jemi dënuar për vepra penale në lidhje me sjelljen profesionale nga një vendim i një autoriteti kompetent të Republikës së Kosovës.

Nënshkrimi i personit të autorizuar _____

Emri dhe pozita e personit që nënshkruan _____

Data _____

Emri dhe adresa e kompanisë _____

Pjesa 4: Forma e dorëzimit të tenderit

Furnizim me paletarë dhe peshore

E dorëzuar nga:

Identifikim i operatorit ekonomik*	
Emri i Kompanisë	
Adresa e plotë	
Përfaqësuar nga:	
Emri & mbiemri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	

* Në rast të grupit të operatorëve, përdoreni një fletë tjetër për të renditur operatorët tjerë. Shih FTD për kërkesat tjera në rast të aplikimit si grup i operatorëve.

Me Çmim:

NR	PËRSHKRIMI	NJËSIA	ÇMIMI PËR NJËSI	TOTAL
1	Paletarë	2		
2	Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 500kg	2		
3	Peshore me kapacitet të peshimit minimum deri në 300kg	1		
			TOTAL	

Çmimet duhet të jenë pa TVSH.

Dokumentet e Bashkangjitura:

- Pjesa 3: Letra përcjellëse dhe Deklarata nën Betim
- Pjesa 4: Forma e dorëzimit të tenderit
- Certifikata e regjistrimit dhe numri fiskal
- Shtojca tjera në rast të organizmit si konsorcium (sipas kërkesave të FTD)
- Dëshmi nga ATK që nuk ka borxhe të papaguara
- Dëshmi të cilësisë (sipas kërkesave të FTD)
- Dëshmi mbi prejardhjen (sipas kërkesave të FTD)
- Dëshmi që oferta është në pajtueshmëri me specifikat teknike të kërkuara
- Deklaratë garancioni.